



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 431
NR. 431 AKTI
VENDIMI

NR. VENDIMI 265
NR. 265

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtar **Besnik HOXHA**

Me pjesmarjen e prokurorit **Dritan Nushi**, asistuar nga sekretare Florinda Nushi, sot më date 08-02-2022, mori në shqyrtim në séance gjyqësore publike çështjen penale në ngarkim:

TE PANDEHURIT: Boiken Lako, identifikuar me ID- Nr. H50525071C, i biri Bujar-it dhe Ermires, i datelindjes 25.05.1975, lindur dhe banues në rrugën "Hajdar Hidri" kulla3, pas Air Albania Tirane, me arsim të lartë, i pa-denuar, me kombësi e shtetësi shqiptare. Mbrojtur në gjykim nga Av.Persida Gega me Nr.6302 license (*me deklaram*) .

AKUZUAR: Për veprën penale "*Ndërtim i paligjshëm*" parashikuar nga Neni 199/a-4 i Kodit Penal .

Gjykata pasi pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar, pasi administroi provat, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të Prokurorit, i cili kërkoj: Deklarimin fajtor të pandehurit Boiken Lako, për kryerjen e veprës penale "*Ndërtim i paligjshëm*" parashikuar nga neni 199/a/pg.4 i K.Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim** si dhe aplikimin e nenit 406 te K.Pr.Penale si dhe të nenit 59 të K.Penal duke pezulluar dënimin dhe vënien në provë të pandehurit; Av.P.Gega, kërkoj një dënim nën minimum si dhe aplikimin e nenit 59 te K.Penal duke pezulluar dënimin dhe vënien në provë për të pandehurin Boiken Lako; I pandehuri Boiken Lako, dakort me avokaten; si deklaroi të mbyllyr shqyrtimin gjyqësor dhe bisedoi çështjen në tëresi .

V E R E N se:

Se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar Gjykatës me kërkesën Nr.2700 Akti, datë 25.10.2021 regjistrimi me objekt : Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal Nr.1732/2021 në ngarkim të pandehurit Boiken Lako, akuzuar për veprën penale të "*Ndërtimit të paligjshëm*" kryer për qëllime fitimi, parashikuar nga neni 199/a-4 i K.Penal, duke i bashkalidhur kërkesës edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli për gjykim.

Me vendimin Nr.2700 akti, dt. 25.10.2021, të gjyqtarit të seances

paraprake është vendosur që çështja të dërgohet për gjykim.

Në seancën paraprake i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar në bazë të neneve 332/c/3 dhe 403 të K.Pr.Penale.

Gjykata pasi degjoi parashtrimin e prokurorit, e pranoi kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar në baze të nenit 405/6 të K.Pr.Penale, pasi çmon se çështja zgjidhet në gjëndjen që janë aktet dhe zhvilloi gjykimin sipas kërkesave të këtij neni, pra duke u bazuar në gjëndjen që janë aktet.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi i provuar se :

Në datë 16.02.2021, Në Komisariatit e Policisë Nr.2 është njoftuar me telefon nga një qytetar, se në rrugën “ Shefqet Musaraj”, në anën e majtë të saj, tek një ndërtesë dy katëshe të pabanueshme, po kryheshin punime ndërtimore pa leje. Pas njoftimit është shkuar në vendin e ngjarjes dhe gjatë kqyrjes është konstatuar se kjo banesë ishte në bllokun e ish magazinave tek ish NISHARAK, në afërsi të UET, e cila ishte marë me qera nga shtetasi Boiken Lako dhe punimet po kryheshin prej tij. Nga kqyrja ka rezultuar se në katin e dytë ishte një ambient holl, me përmasa 30 m² me 7 të përshtatura në dhoma, ku po kryheshin punime ndërtimore. Në dhomën e parafundit nga ana lindore ishte hapur një mur, me përmasa 120x100 cm, një dritare, në dyshtemen e kësaj dhome kishte materiale inerte, tulla dhe llaç, në dhomën e fundit ishte vendosur një dritare duralumini, të gjitha ambientet e brendëshme ishin të ndara në dhoma, nuk kishte dyer të vendosura, tavani i hollit të ambientit ishte i pa suvatuar, por i shtruar me parket laminat.

I pandehuri Boiken Lako ka deklaruar se punimet po kryheshin për llogari të tij, tek ish magazinat tek Nisheraku, të cilën e ka marrë me qera nga shtetasi Dritan Sanxhakatari, duke dashur ta sistemojë me qëllim ta kthente në një studio muzikore. Ka shkuar tek Njësia Administrative Nr.7 dhe ka aplikuar më dt.21.01.2021, për leje për kryerjen e disa punimeve hidraulike, elektrike, suvatime të mureve dhe tavaneve, shtrim me pllaka dhe restaurime të dritareve dhe dyerve të objektit. Pasi ka dalë leja, ka kontaktuar me mikun e tij Klajdi Kruja, për të ndjekur punimet pasi ai vetë ishte i zënë. Në lidhje me dritaren e hapur me përmasa 100x90cm, ka qënë më pare dhe ata kanë hapur dritare që kanë qënë të mbyllura, për ti kthyer në gjëndjen e mëparshme. Këto rrethana dhe fakte janë të shoqëruara me tabelë fotografike.

Sipas shkresës nga IMT-ja Bashkia Tiranë, me shkresën Nr.7821/1 prot. Dt.24.02.2021, inspektorët kanë konstatuar se po bëheshin punime pa dokumentacion në objekt, që konsiston në hapjen e katër dritareve në njerën faqe të objektit, me përmasa 75x140cm dhe 120x140cm, në katin e dytë të ndërtesës. Ndaj subjektit Boiken Lako është mbajtur process-verbal i konstatimit të kundravajtjes Nr.3963 dt.17.02.2021, ndërsa me vendimin Nr.3287 dt.26.02.2021 duke e dënuar me gjobë në shumën 50 000 leke.

Në deklaratimet e tij Boiken Lako është shprehur se me “lejen” me të cilën ishte paisur, ka menduar që mund të bënte ndërhyrje, duke hapur edhe dritaret në katin e dytë dhe të mos kishte problem, por shkresa e Njesisë Administrative Nr.7 është bërë nga pronari dhe jo nga Boiken Lako dhe saktësisht është kërkuar që në objekt të kryhen “ suvatime të pjesshme, lyerje si dhe riparime elektrike dhe hidraulike” si dhe përmendet se ndërhyrjet e bëra jashtë kësaj kërkesë dhe rregullores së Zhvillimit të Territorit e ngarkon subjektin me përgjegjësi ligjore.

Ne ligjin Nr. 10119 dt. 23.04.2009 për “Planifikimin e territorit“, ku bëhet fjalë për “Lejen e zhvillimit“, “Lejen e ndërtimit“, “Leja e infrastrukturës“ dhe “Leja e përdorimit“, janë parashikuar kriteret dhe procedurat ligjore , për të siguruar lejet përkatëse para fillimit të ndërtimit të një objekti ose shtese , gjatë ndërtimit të tij dhe në përfundim të tij.

Nga verifikimet e bëra në hetimet paraprake rezulton se ndërtimi i këtij objekti është pa leje, si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar me Vendimin Nr.408 dt.13.05.2015 “ Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit” nenet 6,7. Në analizë objektive të të gjitha akteve të hetimeve paraprake, rezulton se ka prova të plota e të mjaftueshme që provojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar “ Ndërtim i paligjshëm”, kryer me qëllime fitimi, sipas nenit 199/a-4 i K.Penal, sipas ndryshimeve të bera në Kodin Penal për këtë dispozitë, sipas ligjit 146/2020, pasi godina në fjalë ka vetëm ambiente të dhëna me qera, për shërbime dhe biznese të ndryshme.

Në rastin konkret rezulton se shtetasi Boiken Lako ka kryer punime që kategorizohen si punime që kërkohet pajisja me leje ndërtimi sipas nenit 11 të VKM-së 408 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit". Punimet e kryera nga shtetasi Boiken Lako konsistojnë në krijimin e një strukture të re, duke ndërtuar mure, hapur dritare, kasat e dyerve dhe instalimet elektrike. Shtetasi Boiken Lako nuk ka aplikuar për leje ndërtimi, por thjesht është mbështetur tek një kërkesë e Njësisë Administrative Nr.7. Siç rezulton nga deklaratimet e shtetasit Boiken Lako, proces-verbali për kqyrjen e vendit të ngjarjes dhe tabela fotografike, punimet e kryera nuk janë punime të brendshme, por është ngritur një ndërtim i ri tërësisht e ndryshne nga ajo e mëparshme.

a- Për sa i perket objektit: i pandehuri me veprimet e tij te kundraligjshme **ka cenuar marrëdhëniet juridike te vendosura per te garantuar realizimin e ndërtimeve ne perputhje me rregullat urbanistike, ne funksion te mbrojtjes dhe kontrollit te territorit urban.**

b- Nga ana objektive vepra penale “ Ndërtim i paligjshem “ për qëllimi fitimi, cilesohet e konsumuar kur i pandehuri realizon një ndërtim në tokën, pronësi e tij, **apo të tjetrit pa marre me parë leje ndërtimi nga oganet kompetente administrative** .Në këtë vështrim nga pikepamja objektive vepra penale konsumohet me “ veprime aktive “ te të pandehurit, i cili në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit “ Per urbanistiken “ realizon struktura ndërtimore mbi siperfaqen e tokës pronësi e tij, apo te tjetrit pa u paisur me parë me leje ndertimi nga KRRT -ja e njësisë vendore, ne territorin juridiksional, të së cilës përfshihet ndërtimi. Nga provat e nënshtruara shqyrtimit gjyqesor rezulton plotesisht e provuar se i pandehuri Boiken Lako ka konsumuar elementët e figures së veprës penale të “ Ndërtimit të paligjshem” me qëllim fitimi.

c- I pandehuri Boiken Lako ka mbushur moshen për pergjegjesi penale dhe është i përgjegjshëm nga ana mendore.

d- Vepra penale është kryer nga i pandehuri me dashje direkte, pasi ai ka parashikuar veprimet e pasojat e veprës penale dhe ka dëshiruar ardhjen e tyre. Nga provat e administruara në gjykim provohet se i pandehuri e ka

realizuar vetë ndërtimin, fakt që krijon bindjen tek gjykata se ai ka parashikuar veprimet në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata krahas veshtrimit të përgjithshëm dhe teorik që parashikohet për këto vepra penale, mban në konsideratë dhe çmon edhe subjektin e kesaj veprë penale si dhe përhapjen e kësaj veprë penale. Megjithatë në llojin dhe masën e dënimit ndaj këtij të pandehuri, Gjykata mban parasysh sic u shpjegua dhe më lart, rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të. Kështu Gjykata krahas rrethanave rënduese që parashikon vepra mban parasysh si rrethana lehtësuese për të pandehurit faktin që ai tregoi pendim të thellë, i pa denuar me parë, qëllimin e kryerjes së saj, etj.

Gjykata arsyeton se ndaj të pandehurit Boiken Lako duhet të aplikohet neni 59 i K.Penal, meqënëse sipas arsytimit se nga ky i pandehur plotësohen kriteret ligjore të kësaj dispozite, rrezikshmëria e pakët e personit që provohet nga fakti që është i pa denuar, nga qëndrimi i tij korrekt në hetim dhe gjykim, profesioni tij si dhe rrethanat, në të cilën është kryer vepra penale. Për sa sipër gjykata çmon se ndaj të pandehurit duhet të aplikohet neni 59 i K.Penal. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e autorit të veprës penale përfshihet në kategorinë e alternativave të dënimit me burgim dhe synon të zgjerojë mundësitë e edukimit dhe rehabilitimit në shoqëri të personit që ka kryer veprën penale në formë të ndryshme nga ajo e kufizimit të lirise së tij personale.

PER KETO ARSYE:

Mbeshtetur në nenet 384 e 390 të Kodit Pr. Penale Gjykata

V E N D O S I

- Deklarimin fajtor të pandehurit **Boiken Lako**, për kryerjen e veprës penale të "*Ndërtimit të paligjshëm*" për qëllime fitimi, parashikuar nga neni 199/a pg.4 i K.Penal e në bazë të kesaj dispozite e dënon atë me **3 (tre) vjet burgim.**

- Në aplikim të nenit 406/1 K.Pr.Penale mases së mesiperme i zbritet 1/3 e saj dhe përfundimisht e dënon të pandehurin **Boiken Lako**, me **2 (dy) vjet burgim.**

- Në bazë të nenit 59 të K.Penal Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mësipërm për një afat 3 (tre) vjet, me kusht që gjatë kësaj periudhe i pandehuri të mos kryej vepra tjeter penale .

- Urdhërohet i pandehuri të mbajë kontakte me Sherbimin e Provës Tiranë.

-Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, (i ndryshuar me ligjin Nr 36/2017, afati i provës fillon nga e nesërmeja e shpalljes së këtij vendimi .

-Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen të pandehurit.

-Kunder vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit vendimit

U shpall sot në Tiranë, më dt. 08-02-2022

SEKRETARE
GJYQTAR

Florinda NUSHI
Besnik HOXHA

SHPENZIMET GJYQESORE

Taksa njoftimit 1x150 leke

Shpenzimet procedurale 500 leke

[shqiptaria.com]